

Westin: Ne po ikim, kujdes me taksat

Intervistoi Eltion Hoxha

Përfaqësuesja e Përherhshme e FMN-së në Shqipëri, Ann-Margret Westin, flet për "Shekulli"-n mbi zhvillimet në vend

"FMN-ja do të kishte dashur më shumë progres ndër vite me administrimin e taksave. Në 2009-n duhet një politikë fiskale më e kujdesshme"

Përfaqësuesja e Përherhshme e FMN-së në Shqipëri, Ann-Margret Westin, komenton sektorët që ndikohen nga kriza

FMN-ja: "Ku ju prek kriza botërore"

"Parashikimi ynë për rritjen ekonomike për vitin 2009 është 3.5-4%. Nëse rritet kreditimi, mund të jetë mbi 4%"

Statusi:

Ne do të vazhdojmë të japim këshilla për politikat ekonomike dhe ndryshimi kryesor nga statusi i tanishëm i programit, është se ne do të kemi shkëmbime më të rralla me Shqipërinë, si dhe në mungesë të një programi, do të kemi më pak ndikim në hartimin e politikave ekonomike.

Kriza:

Ne presim një ngadalësim në rritjen e kredisë, pasi bankat do të jenë më të kujdesshme. Ekonomia shqiptare do të ndikohet kryesisht nga ngadalësimi i ekonomisë globale nëpërmjet rënies së kërkesës për eksporte, investimeve dhe dërgesave të emigrantëve.

Porosia:

Duke marrë në konsideratë krizën globale aktuale, është më e rëndësishme se kurrë që qeveria të ndjekë politika makroekonomike të shëndosha. Mesazhi që ne po përpiqemi të japim në këtë pikë është që duhet të jeni tepër të kujdesshëm.

Një politikë fiskale më e shtrënguar në 2009-n, krahasuar me 2008-n, do të jetë pjesë kyçe e këtyre politikave të matura. Duke marrë në konsideratë kushtet më të vështira të financimit këtë vit, ne kemi rënë dakord me autoritetet për të reduktuar deficitin e buxhetit nën 4 për qind, për të shmangur ngushtimin e aksesit në kredi për investimet e sektorit privat.

Taksat:

Në të ardhmen, ne akoma po presim për një spirancë për politikat fiskale, në mungesë të një programi me FMN-në: një angazhim ndaj një rregulli fiskal qoftë ky një tavan për shpenzimet apo për defiçitin, do të ndihmonte në forcimin e disiplinës fiskale dhe në reduktimin e borxhit publik.

Rritja ekonomike 2008:

Duke parë disa shqetësime lidhur me klasifikimin e bizneseve të rinj, ka arsye për të besuar se vlerësimet e PBB-së tremujore të publikuara së fundmi, e mbivlerësojnë nivelin e vërtetë të rritjes.

P.sh. formalizimi i ekonomisë, mund të raportohet si rritje e aktivitetit ekonomik, nëpërmjet rritjes së pagesave të TVSH-së. Prandaj, për momentin ne po mbajmë vlerësimin tonë për një rritje reale prej 6 për qindësh në 2008-n.

Rritja ekonomike 2009:

Ne gjithashtu mbajmë parashikimin tonë për një rritje reale 3.5-4 për qind për vitin 2009. Nëse kreditimi do të jetë në nivele më të mira se ai që është parashikuar, ky vit mund të ketë rritje edhe më të lartë se 4 për qind.

Maturia:

Në të njëjtën kohë, të tjerë argumentojnë se duke marrë në konsideratë klimën e paqartë aktuale globale dhe faktin që ky është një vit zgjedhor, maturia në këtë kohë është thelbësore. Në fakt, ka vende ku qeveria dhe opozita kanë rënë dakord së bashku për të nënshkruar një marrëveshje me FMN-në para zgjedhjeve, në mënyrë që të forcojnë besimin.

Shqipëria nuk do të jetë më nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të FMN-së, por në një mbikëqyrje të disa parametrave. Konkretisht, cili do të jetë roli i FMN-së në Shqipëri, duke nisur nga muaji shkurt?

Me mbarimin e programit aktual 3-vjeçar, PRGF/EFF-ja me FMN-në, marrëdhëniet e Shqipërisë me Fondin, do të kufizohen kryesisht në konsultimet e Nenit IV dhe në programet tona të asistencës teknike dhe të trajnimeve. Do të ketë pa dyshim mundësi për t'u takuar dhe për të diskutuar edhe gjatë mbledhjeve vjetore dhe atyre të pranverës.

Konsultimet e Nenit IV janë në zemër të punës së monitorimit të FMN-së. FMN-ja ka një mandat për të mbikëqyrur sistemin monetar ndërkombëtar dhe të vëzhgojë politikat ekonomike dhe financiare të 185 vendeve tona anëtare.

Një mision i Nenit IV e viziton një vend çdo vit ose një herë në dy vjet, për të grumbulluar informacion dhe për të shkëmbyer pikëpamje me qeverinë dhe zyrtarët e Bankës Qendrore. Ne gjithashtu takohemi me të tjerë aktorë, si parlamentarë, përfaqësues të biznesit, të sindikatave dhe të shoqërisë civile. Gjetjet e misionit prezantohen në një raport të stafit, që ne ja parashtrijmë Bordit Ekzekutiv të FMN-së.

Aty vihen në dukje rreziqet e mundshme ndaj stabilitetit dhe rritjes ekonomike dhe jepen këshilla për rregullimet e nevojshme politike. Vlen të theksohet se, që kur Shqipëria është bërë anëtare e FMN-së në vitin 1991, ne kemi ndërmarrë konsultime të Nenit IV me Shqipërinë, pra kjo nuk është ndonjë gjë e re. Konsultimi më i fundit i këtij lloji ka ndodhur pranverën e kaluar.

Pra, ndërsa ne do të vazhdojmë të japim këshilla për politikat ekonomike, ndryshimi kryesor nga statusi i tanishëm i programit është se ne do të kemi shkëmbime më të rralla me Shqipërinë, si dhe në mungesë të një programi, do të kemi më pak ndikim në hartimin e politikave ekonomike.

Pra, ne do të jemi si një këshilltar i jashtëm që jep këshilla në mënyrë periodike. Shqipëria do të vazhdojë të ketë akses në asistencën tonë teknike. Megjithatë, jashtë kontekstit të një programi, Shqipërisë mbase do t'i duhet të paguajë për një pjesë të kësaj asistence në të ardhmen, në bazë të reformave të pritshme brenda FMN-së.

Znj. Westin, përfundimi i misionit të FMN-së ka ndarë opinionin publik në vend në dy kampe; njëra palë kërkon shtyrjen e asistencës së FMN-së në vendin tonë dhe pala tjetër deklaron se Shqipëria nuk ka nevojë për një shtyrje të misionit. A mendoni se qeveria mund të funksionojë pa ndihmën e Fondit?

Së pari, më lejoni të vë në dukje se kurdoherë që ka një program të FMN-së që mbështet një vend me hua, ky është gjithmonë me kërkesë të vetë vendit.

Së dyti, programet tona nuk janë hartuar për të zgjatur përgjithmonë, por sigurisht që qëllimi i tyre është që vendet të maturohen nga financimet e FMN-së në një pikë të caktuar. Çështja kryesore - dhe kjo është një çështje gjykimi - është se kur duhet thënë mjaft dhe të kalohet nga programet e FMN-së që mbështesin me hua, në një stad monitorimi.

Disa vende mbajnë një qëndrim më të matur, duke vazhduar të kenë programe paraprake për një periudhe kohe, si një garanci për investitorët e huaj, që politikat ekonomike janë në rrugën e duhur.

Një shembull i tillë është Serbia, e cila sapo ka nënshkruar një program paraprak me ne. Të tjera vende theksojnë se fakti që një vend nuk kërkon program me FMN-në, dërgon në vetvete një sinjal pozitiv ndaj investitorëve që vendi është maturuar mjaftueshëm për të ecur vetë.

Shqipëria ka bërë shumë progres gjatë programit të fundit dhe është maturuar nga një ekonomi me të ardhura të ulëta, në tashmë një ekonomi gati për t'iu bashkuar vendeve në zhvillim. Në këtë kuptim, mund të argumentohet që Shqipëria do të jetë e gatshme për t'u maturuar nga financimet e FMN-së.

Në të njëjtën kohë, të tjerë argumentojnë se duke marrë në konsideratë klimën e paqartë aktuale globale dhe faktin që ky është një vit zgjedhor, matura në këtë kohë është thelbësore. Në fakt, ka vende ku qeveria dhe opozita kanë rënë dakord së bashku për të nënshkruar një marrëveshje me FMN-në para zgjedhjeve, në mënyrë që të forcojnë besimin.

Cilat kanë qenë porositë e fundit të FMN-së për qeverinë shqiptare?

Duke marrë në konsideratë krizën globale aktuale, është më e rëndësishme se kurrë që qeveria të ndjekë politika makroekonomike të shëndosha. Mesazhi që ne po përpiqemi të japim në këtë pikë është që duhet të jeni tepër të kujdesshëm. Një politikë fiskale më e shtrënguar në 2009-n, krahasuar me 2008-n, do të jetë pjesë kyçe e këtyre politikave të matura.

Duke marrë në konsideratë kushtet më të vështira të financimit këtë vit, ne kemi rënë dakord me autoritetet për të reduktuar deficitin e buxhetit nën 4 për qind, për të shmangur ngushtimin e aksesit në kredi për investimet e sektorit privat.

(Në ligjin e miratuar të buxhetit thuhet se deficiti i buxhetit do të jetë 4.2 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), por duke ditur vonesat e njohura në investime, ne presim që në fund të vitit, deficiti të jetë rreth 3.9% e PBB).

Gjithashtu, me një nivel kontigjence për shpenzimet prej 2% të PBB-së, buxheti ka mbrojtje të mjaftueshme. Në sektorin financiar, Banka e Shqipërisë do të duhet të vazhdojë punën e saj shumë të mirë në mbikëqyrjen bankare dhe me një monitorimin frekuent.

A do ta prekë kriza botërore Shqipërinë, nëse po, cilët janë sektorët më të ekspozuar?

Fakti që ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar nuk janë krejtësisht të integruar me pjesën tjetër të ekonomisë globale, ka siguruar një mbrojtje të rëndësishme nga kriza globale financiare. Sistemi bankar shqiptar nuk ka pasur ekspozim direkt ndaj instrumenteve toksikë që ishin në qendër të krizës së kredive në Shtetet e Bashkuara.

Megjithatë, pothuaj të gjitha bankat janë të zotëruara nga të huajt dhe duke qenë se bankat mëmë mund të kenë qenë më të prekura nga kriza globale e kredisë, ato nga ana e tyre mund të kenë më pak fonde në dispozicion për filialet apo degët e tyre në Shqipëri.

Prandaj, ne presim një ngadalësim në rritjen e kredisë, pasi bankat do të jenë më të kujdesshme. Ekonomia shqiptare do të ndikohet kryesisht nga ngadalësimi i ekonomisë globale nëpërmjet rënies së kërkesës për eksporte, investimeve dhe dërgesave të emigrantëve, si dhe siç e përmenda, më pak kredi.

Kërkesa për eksporte mund të dëmtojë kryesisht industrinë e rieksperteve të këpucëve dhe veshjeve, por sektorë të tjerë do të ndikohen gjithashtu. Ndërkohë, dërgesat e emigrantëve kanë qenë shumë të rëndësishme për të rritur të ardhurat familjare dhe kanë qenë veçanërisht të rëndësishme si një mbrojtje për familjet më të varfra.

Znj. Westin, nëse bëhet një bilanc i bashkëpunimit Shqipëri-FMN, çfarë gjërash mund të ishin realizuar më mirë, ose që nuk u arritën të realizoheshin?

Së pari, dua të them se një sukses i madh i Shqipërisë është arritja e stabilitetit makroekonomik në këto vitet e fundit, me rritje të lartë dhe të qëndrueshme ekonomike dhe

me inflacion të ulët dhe stabil. Kjo është një arritje e autoriteteve shqiptare, i kësaj qeverie dhe i atyre të mëparshme, si dhe e Bankës së Shqipërisë, në bashkëpunim me ne.

Tani, duke u fokusuar në fushat ku ne do të kishim dashur më shumë progres, më lejoni të përmend administrimin e taksave. Reformat duket se më në fund tani po marrin hov në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në një pjesë të madhe të ndihmuar nga Programi i Pragut i Mijëvjeçarit dhe asistencë teknike e ofruar nga ne.

Ne i mirëpresim zhvillimet e fundit, siç edhe u konstatuan nga misioni ynë i asistencës teknike në vjeshtë; por në të njëjtën kohë do të kishim shpresuar për më shumë progres edhe në vitet e mëparshme, duke marrë në konsideratë asistencën e madhe teknike të ofruar në këtë fushë, jo vetëm nga ne, por edhe nga donatorë të tjerë.

Në të ardhmen, ne akoma po presim për një spirancë për politikën fiskale, në mungesë të një programi me FMN-në: një angazhim ndaj një rregulli fiskal, qoftë ky një tavan për shpenzimet apo për deficitin, do të ndihmonte në forcimin e disiplinës fiskale dhe në reduktimin e borxhit publik.

Ditët e fundit ka pasur shumë debate mbi rritjen ekonomike. FMN-ja i qëndron versionit të muajit nëntor për një rritje vjetore ekonomike prej 6%. Kryeministri i referohet Instat-it për rritjen vjetore të 3-mujorit të tretë prej 9.9 % dhe Ministria e Financave ka një projeksion 7-8%. A mendoni se është shumë esencial debati për shifrën e rritjes ekonomike dhe sa i rëndësishëm është parashikimi i kësaj shifre?

Së pari, dua të them se ne e mirëpresim shumë prodhimin e vlerësimeve tremujore të PBB-së nga Instat-i dhe jemi të lumtur që kemi qenë në gjendje për ta mbështetur këtë proces nëpërmjet asistencës teknike të një eksperti. Vlerësimet tremujore të PBB-së bazohen në një nënseri treguesish ekonomike tremujore dhe si të tillë janë më pak të plota se vlerësimet vjetore të PBB-së.

Qëllimi i tyre është të japin një indikacion më të shpejtë se sa vlerësimet e vjetore të PBB-së se ku po shkon ekonomia. Vlerësimet tremujore të publikuara së fundmi, janë të parat në llojin e tyre dhe do të jenë subjekt i rishikimeve të mëtejshme.

Në mënyrë të veçantë, duke parë disa shqetësime lidhur me klasifikimin e bizneseve të reja, ka arsye për të besuar se vlerësimet e PBB-së tremujore të publikuara së fundmi, e mbivlerësojnë nivelin e vërtetë të rritjes.

P.sh. formalizimi i ekonomisë mund të raportohet si rritje e aktivitetit ekonomik, nëpërmjet rritjes së pagesave të TVSH-së. Prandaj, për momentin ne po mbajmë vlerësimin tonë për një rritje reale prej 6 përqindësh në 2008-n.

Ndërsa rritja ekonomike ka qenë më e fortë se sa ishte parashikuar në gjysmën e parë të vitit, situata aktuale botërore e frenimit ekonomik do të ndikojë kryesisht rritjen në tremujorin e katërt, pra tre muajt e fundit të vitit 2008 dhe gjatë vitit 2009. Në fakt që në tremujorin e tretë

të vitit 2008, ka pasur shenja të dobësimit krahasuar me gjysmën e parë të vitit. Ne, gjithashtu, mbajmë parashikimin tonë për një rritje reale 3.5-4 për qind për vitin 2009.

Nëse kreditimi do të jetë në nivele më të mira se ai që është parashikuar, ky vit mund të ketë rritje edhe më të lartë se 4 për qind. Ia vlen të nënvizohet se këto parashikime përsëri tregojnë për një rritje solide në Shqipëri, sidomos po ta krahasosh me vende të tjera në rajon dhe në botë. Në publikimin tonë të Parashikimit Ekonomik Botëror, të azhornuar në nëntor të 2008-s, parashikimet për normat e rritjes ekonomike për 2008-'09-n u ulën pothuaj për të gjithë vendet e botës.

Gjithashtu, parashikimi ynë për një rritje rreth 3.7 për qind në 2009-n për Shqipërinë, duhet të krahasohet me mesataren prej 2.5 për qind rritje, që parashikohet për Europën Qendrore dhe Lindore në 2009-n. Një kuptim i mirë i nivelit të rritjes së PBB-së është padyshim thelbësor për hartimin e politikave dhe për analizat ekonomike.

Në të ardhmen, kur të dhënat zyrtare në Shqipëri të jenë përmirësuar më tej si rezultat i rafinimeve të mëtejshme në metodologji dhe përdorimit më të mirë të burimeve ekzistuese të të dhënave dhe krijimit të burimeve të reja të të dhënave, ne presim që do të ketë më pak debat për shifrat historike të PBB-së dhe për parashikimet për rritjen.

Në mënyrë të veçantë, unë besoj se do të ketë më shumë parashikime, pasi dhe institucionet kryesore private financiare, sidomos bankat më të mëdha, do të bëjnë edhe ato parashikimet e tyre makroekonomike, dhe unë pres që do të ketë një konvergjencë të parashikimeve të ndryshme të rritjes.